

**BARKODI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE**

**MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025**

**KUALIFIKIMI PROFESIONAL "TREGTI"**

**Udhëzime për maturantin/kandidatin**

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

**Për përdorim nga komisioni i vlerësimit**

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30		
Pikët								

Totali i pikëve

**KOMISIONI I VLERËSIMIT**

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Ligji i kërkesës konstaton këtë: 1 pikë
- A) Me rritjen e çmimit , sasia e kërkuar rritet.
  - B) Në qofte se ulet çmimi, sasia e kërkuar rritet.
  - C) Me uljen e çmimit, sasia e kërkuar ulet.
  - D) Me uljen e çmimeve, kërkesa rritet.
2. Kur vizatojmë një lakore oferte për televizorë , cili nga faktorët e mëposhtëm lejohet te ndryshojë midis pikave të ndryshme ne lakoren e ofertës: 1 pikë
- A) Kostoja e faktorëve të prodhimit për prodhuesin.
  - B) Pritjet e ardhshme të prodhuesit.
  - C) Çmimi I televizorëve.
  - D) Teknologjia në dispozicion të prodhuesve.
3. Kur çmimi është 5 , sasia e ofruar është 10. Kur çmimi është 10 sasia e ofruar është 20. Sa është elasticiteti I ofertës në lidhje me çmimin? 1 pikë
- A) 1
  - B) 0.5
  - C) 2
  - D) 1.5
4. Ofrimi i trajnimeve për individët e papunë është menduar kryesisht për të ulur : 1 pikë
- A) Papunësinë friksionale.
  - B) Papunësinë sezonale.
  - C) Papunësinë strukturore.
  - D) Papunësinë ciklike.
5. Arkëtohen në llogarinë bankare "Të drejtat ndaj klientëve" për 30 000 lekë. Ky veprim sjell: 1 pikë
- A) Shtim të detyrimeve
  - B) Shtim të të drejtave
  - C) Pakësim të mjeteve monetare
  - D) Shtim të mjeteve monetare
6. Llogaria "Mjete transporti" është llogari: 1 pikë
- A) Aktive afatshkurtër
  - B) Aktive afatgjatë
  - C) Kapitali
  - D) Detyrime

7. Shoqëria blen një tokë me pagesë të mëvonshme. Ky veprim sjell: **1 pikë**
- A) Shtim të aktiveve
  - B) Shtim të detyrimeve
  - C) Pakësim të detyrimeve
  - D) Pakësim të kapitalit
8. Llogaria "Shpenzime për energjinë elektrike" është llogari: **1 pikë**
- A) Aktive
  - B) Detyrime
  - C) Kapitali
  - D) Rezultati
9. Shoqëria për vitin 2022 ka rezultuar me një humbje prej 200 000 lekësh. Kjo vlerë sjell: **1 pikë**
- A) Shtim të aktiveve
  - B) Shtim të detyrimeve
  - C) Pakësim të kapitalit
  - D) Shtim të kapitalit
10. Shoqëria likuidon nga llogaria bankare pagat e punonjësve. Ky veprim sjell: **1 pikë**
- A) Pakësim të shpenzimeve
  - B) Shtim të shpenzimeve
  - C) Shtim të mjeteve monetare
  - D) Pakësim të detyrimeve
11. Një person fizik ka dhënë me qira një ambient me vlerë 40 000 lekë. Tatimi në burim është 15%. Vlera e tatimit në burim është: **1 pikë**
- A) 6 000 lekë
  - B) 34 000 lekë
  - C) 4 000 lekë
  - D) 46 000 lekë
12. Kur paguesi tatimor dhe destinuesi tatimor nuk janë i njëjti person kemi të bëjmë me: **1 pikë**
- A) Tatime të drejtpërdrejta
  - B) Tatime të tërthorta
  - C) Taksa vendore
  - D) Taksa kombëtare
13. Ndërruesit e markës: **1 pikë**
- A) Kanë besnikëri të lartë mbi markën
  - B) Kanë marrëdhënie të fortë me produktin
  - C) Kanë përfshirje të lartë personale
  - D) Ndikohen lehtë nga faktorët mjedisorë

14. Sa më i lartë të jetë niveli i përfshirjes së konsumatorit me produktin, aq më shumë: **1 pikë**
- A) Vështirësohet komunikimi
  - B) Ulet kënaqësia e konsumatorit
  - C) Rritet niveli i besnikërisë
  - D) Ulet cilësia e produktit
15. Produkti i gatshëm: **1 pikë**
- A) Merret drejtpërdrejtë nga natyra
  - B) Nuk pëson ndryshim teknologjik
  - C) Nuk i ka kaluar të gjitha fazat e prodhimit
  - D) I ka kaluar të gjitha fazat e prodhimit
16. Është karakteristikë e shërbimeve: **1 pikë**
- A) Magazinimi
  - B) Paketimi
  - C) Pandashmëria
  - D) Transporti
17. Termat "magazinë" dhe "magazinim": **1 pikë**
- A) Kanë të njëjtin kuptim
  - B) Magazina është objekt, magazinimi është proces
  - C) Janë shërbime që ofron prodhuesi
  - D) Lidhen vetëm me procesin e prodhimit
18. E-Commerce: **1 pikë**
- A) Ul kostot e biznesit
  - B) Rrit reputacionin e kompanisë
  - C) Shkakton evazion fiskal
  - D) Rrit papunësinë
19. Vlerësimi i lekut në raport me USD i bën mallrat e ardhura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës: **1 pikë**
- A) Më të lira
  - B) Më të shtrenjta
  - C) Të një cilësie më të lartë
  - D) Të një cilësie më të ulët
20. Pjesëmarrja e një vendi në tregun ndërkombëtar sjell: **1 pikë**
- A) Rritje të inflacionit
  - B) Konflikt ndërmjet bizneseve vendase
  - C) Rritje të normës së papunësisë
  - D) Rritje të mirëqenies

21. Argumentoni si ndikojnë faktorët e mëposhtëm ne ofertë:

4 pikë

Ulja e çmimit të tullave në industrinë e ndërtimit, si do ndikohet oferta për banesa të reja?

---

---

---

Vendosja e akcizës për makineritë e prodhimit të qeseve plastike, si do ndikojë në ofertën e qeseve plastike ?

---

---

---

Zbulimi i naftës në detin Egje si do ndikojë në ofertën e saj?

---

---

---

Një ndërmarrje pëlhurash prodhon vetëm basme dhe fanellatë. Me afrimin e stinës së dimrit pritjet të rritet çmimit i fanellatës ne periudhën e ardhshme. Çdo te ndodhë me prodhimin e basmës, po me ofertën e saj?

---

---

---

---

22. Paraja kryen funksionet si mjet këmbimi, matëse vlere dhe ruajtëse e vlerës.

4 pikë

Listoni katër nga cilësitë që ka paraja si mjet këmbimi:

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

23. Shoqëria "GAMA" ka kryer këto veprime ekonomike:

- A) Në datën 01.01.2022 ka blerë një ndërtesë me vlerë 4 000 000, norma e amortizimit 5%, paratë janë paguar nga llogaria bankare.  
 B) Në datën 01.05.2022 është blerë një tokë me vlerë 5 000 000 lekë me pagesë të mëvonshme.  
 C) Në datën 31.12.2022 regjistrohet amortizimi i ndërtesës.

Kërkohe:

1. Të llogaritet amortizimi i ndërtesës. **1 pikë**  
 2. Të regjistrohet blerja e ndërtesës. **1 pikë**  
 3. Të regjistrohet blerja e tokës. **1 pikë**  
 4. Të regjistrohet amortizimi i ndërtesës. **1 pikë**

1. \_\_\_\_\_

**Ditari i përgjithshëm**

Data	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi

24. Për kompaninë "Mega" në muajin mars kemi këto të dhëna për pagat e punonjësve: paga bazë 450 000 lekë, shtesa mbi pagat për orët jashtë orarit 30 000 lekë, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që paguan punëmarrësi 54 000 lekë, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që paguan punëdhënësi 80 000 lekë, TAP-i 50 000lekë.

Kërkohe:

1. Të llogaritet paga bruto **1 pikë**  
 2. Të regjistrohen pagat e punonjësve sipas listëpagesës së muajit mars **1 pikë**  
 3. Të regjistrohen sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që paguan punëdhënësi. **1 pikë**  
 4. Të kryhet pagesa e pagave **1 pikë**

1. \_\_\_\_\_

**Ditari i përgjithshëm**

Data	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi

25. Për muajin maj 2022, nga shoqëria "Prata" kemi këto veprime ekonomike:

- Pranohet fatura për blerjen e mallrave me pagesë të mëvonshme për 40 000 lekë, TVSH 20%.
- Sipas faturës tatimore janë shitur mallra me arkëtim të mëvonshëm për 60 000 lekë, TVSH 20%.
- Sipas vërtetimit bankar janë likuiduar detyrimet për mallrat e blera ndaj furnitorit për 48 000 lekë.
- Është paguar nga arka qiraja e muajit prill për 30 000 lekë.

Kërkohet:

- Të regjistrohet blerja e mallrave
- Të regjistrohet shitja e mallrave
- Të regjistrohet likuidimi i detyrimit nga llogaria bankare.
- Të regjistrohet qeraja për muajin prill

1 pikë

1 pikë

1 pikë

1 pikë

Shoqëria përdor metodën e inventarizimit periodik

#### Ditari i përgjithshëm

Data	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi

26. Firma "X" importon kostume sportive . sasia e importuar është:

- |                                |                    |                      |
|--------------------------------|--------------------|----------------------|
| 1. Kostume sportive për burra  | 300 copë , me çmim | 5 000 lekë për copë. |
| 2. Kostume sportive për gra    | 400 copë , me çmim | 6 000 lekë për copë  |
| 3. Kostume sportive për fëmijë | 700 copë , me çmim | 3 000 lekë për copë  |

Tarifa doganore është 12%, me kushtin që shuma e paguar për copë nuk duhet të jetë më e vogël se 450 lekë për copë.

Kërkohet të llogaritet detyrimi doganor për:

- Kostumet sportive për burra
- Kostumet sportive për gra.
- Kostumet sportive për fëmijë
- Në total

1 pikë

1 pikë

1 pikë

1 pikë

27. Konsumatorët klasifikohen edhe sipas përfshirjes së tyre me markat. Listoni këto 4 kategori. **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

28. Tregoni cilat ishin mangësitë e sistemit të shkëmbimit mall me mall. **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

29. Listoni katër nga karakteristikat e tregut. **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

30. Tregoni katër karakteristika të tregtisë elektronike. **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_